



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**



Nr. 1457 Prot

Tiranë, më 20.12.2022

Nr. 1790 Dosje

**VENDIM**  
**PER PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT**

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 982 (31134-02784-80-2022) Regj.Them, të lëshuar më datë 20.05.2022 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1790, Datë 18.11.2022 kërkesën e kreditorit Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit I.K.M.T, ndaj debitorit Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k, në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim për Dënim me Gjobë Nr. 281, datë 17.11.2021.

Pasi fillova ekzekutimin e detyrueshëm duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 1245 Prot, datë 21.11.2022 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në vënien e sekuestros konservative tek kreditë, aksionet dhe asetet e Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k dhe Z. Isuf Meçi (në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k).

Urdhërat për vendosjen e sekuestrove konservative janë dërguar nga Përmbaruesi Gjyqësor Altin Vako pranë:

- DRSHTRR Gjirokastër me shkresën Nr. 1421 Prot, datë 12.12.2022
- Qëndrës Kombëtare të Biznesit me shkresën Nr. 1420 Prot, datë 12.12.2022
- Bankave Nivelit II me shkresën Nr. 1422 Prot, datë 12.12.2022

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për Ekzekutimin e plotë të Titullit Ekzekutiv më palët e lartpërmendura,

**KONSTATOJ**

Se pas dërgimit të Urdhërit për Vënien e Sekuestros Ekzekutive Nr. 1442 Prot, datë 16.12.2022 pranë "Banka Kombëtare Tregtare" sh.a., dhe nxjerrjes së llogarisë pranë kësaj banke, informohem se e gjithë shuma e detyrimit kishte kaluar në llogarinë e Përmbaruesit Gjyqësor, duke zbatuar vendimin e gjykatës.



Person Fizik "ALTIN VAKO", Nr. NIPT-i: L51314013N  
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë  
Tel. 04 23 000 39

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedures Civile dhe të Ligjit Nr. 26/2019, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

### VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 982 (31134-02784-80-2022) Regj.Them, datë 20.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi detyrimi është shlyer tërësisht.
2. DRSHTRR Gjirokastër të bëjë ç'bllokimin e dokumentacionit të mjeteve që mund të ketë në pronësi Shoqëria "EUROBETON" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K23116602P dhe të bëjë ç'bllokimin e dokumentacionit të mjeteve që mund të ketë në pronësi Z. Isuf Tomor Meçi, i datëlindjes 09.07.1967 (në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k), të cilat mund të jenë bllokuar me anë të shkresës Nr. 1421 Prot, datë 12.12.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
3. Bankat e Nivelit II të bëjnë ç'bllokimin e depozitave, kredive apo llogarive bankare të Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K23116602P, dhe të Z. Isuf Tomor Meçi, i datëlindjes 09.07.1967 (në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k), të bllokuara me anë të shkresës Nr. 1422 Prot, datë 12.12.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
4. Qendra Kombëtare e Biznesit të bëjë ç'bllokimin e aksioneve apo kredive të Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K23116602P dhe të Z. Isuf Tomor Meçi, i datëlindjes 09.07.1967 (në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k), pranë shoqërive si më poshtë:
  - ✓ - Shoqërisë "EUROBETON" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i K23116602P
  - Shoqërisë "IRA-3" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i K93518601N
  - Shoqërisë "DARI-SHIT" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i K93628601U
  - Shoqërisë "DARI INVEST 2" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i L92608601L
  - Shoqërisë "DARI INVEST" Sh.p.k, me Nr. NIPT-i L43416602E

të bllokuara me anë të shkresës Nr. 1420 Prot, datë 12.12.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës kompetente, brenda 5-ditësh.

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**ALTIN VAKO**



Person Fizik "ALTIN VAKO", Nr. NIPT-i: L51314013N  
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë  
Tel. 04 23 000 39